



Republika e Kosovës \* Republic of Kosovo

Komuna \* Municipality

Hani i Elezit



DATE: 26.03.2025

NR.09/ 2040 /2025

## KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës: **659-25-2059-1-4-7 & KKHE(VM) 25-004-1-4-7**

**KOMUNA HANI I ELEZIT**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), perfaqesura nga Xhevdet Bushi në njërën anë; dhe

**ENDRITI PELET SHPK, Paldenicë – Hani i Elezit**, (në vazhdim "Furnizuesi"), perfaqesuar nga **Naser Krasniqi** në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:  
**Furnizim me dru per SHFMU. Ilaz Thaçi – Hani i Elezit**, me numër identifikues: **659-25-2059-1-4-7**

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

| Nr. | Grupi                                                 |
|-----|-------------------------------------------------------|
| 1   | Furnizim me dru per SHFMU. Ilaz Thaçi – Hani i Elezit |

### Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 7 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë *Komuna Hani i Elezit sipas lokacionit të percaktuar nga AK*

2.3 Inkotermi<sup>1</sup> i zbatueshëm do të jetë .

### Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

### Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **950,00 €**; [*Nëntqindë e pesëdhjetë euro /00 cent*] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 ÇMIMI do të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[N/A]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: **N/A**

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

<sup>1</sup> Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

## Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE<sup>2</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.


Për Autoritetin Kontraktues

**KOMUNA HANI I ELEZIT**

|             |                                                                                     |
|-------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:       | Xhevdet Bushi                                                                       |
| Pozita:     | Zyrtar i përgjeshëm i prokurimit                                                    |
| Nënshkrimi: |  |
| Data:       | 26/03/2025                                                                          |
| Vula:       |  |

Për Furnizuesin/realizuesin e shërbimeve

**ENDRITI PELET SHPK.**

|             |                                                                                     |
|-------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:       | NASER KRASNICU                                                                      |
| Pozita:     | DREJTOR                                                                             |
| Nënshkrimi: |  |
| Data:       | 26/03/2025                                                                          |
| Vula:       |  |

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-25-2059-1-4-7 : KKHE-25-004-1-4-7

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës               |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
|---------------------------------------------------|-----------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përshkrimi i nenit                                | Nr. Nenit |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha                      | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|                                                   | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe .                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Siguria e ekzekutimit                             | 9.1       | [N/A]                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Sigurimi                                          | 10.1      | [N/A]                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Programi i ekzekutimit                            | 11        | Kohëzgjatja e kontrates eshte 7 ditë (shtatë ditë) nga nenshkrimi i saj                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Tatimet dhe marrëveshjet doganore                 | 12.1      | Tatimet dhe te gjitha taksat mbulohen nga OE.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Cilësia e furnizimeve                             | 18.2      | Drute duhet te jene konform kerkeses se kuotimit, me gjatesi min 1 meter dhe trashesi(diameter) min.10 cm                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Inspektimi dhe testimi                            | 19.2      | Drute duhet te maten dhe te sharrohen sipas kerkeses se AK-se                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Pagesa                                            | 20.1      | Pagesa do te behet pas pranimit te furnizimit ne cilesi dhe sasi te pranueshme per AK dhe pas pranim te fatures se nga OE.<br>Pagesa do te behet brenda afati ligjor                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Dorëzimi                                          | 21.3      | Konform specifikave te kerkuar ne dosje te tenderit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Obligimet e garancionit                           | 24.1      | N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|                                                   | 24.5      | [N/A]                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Shërbimet pas shitjes                             | 25.1      | [N/A]                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes               | 31.2      | Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit te Elezit ose permes procedurave alternative te zgjidhje se mosmarrveshjeve-procedurat e ndermjetesimit me pajtimin e te dy paleve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore | 32.1      | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Ferizaj dega ne Kaçanik-] në pajtim me ligjin në Kosovë.<br><br>oseb) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]. |